



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGJENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. f. pag. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	03-4188/13
Data Datum Date	06.12.2013
PRISHTINE	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr. Regj. 45819/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Ukë Rugova nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 par. 1 i ndëshkuar sipas nenit 16 par. 1.3 të Ligjit nr. 04/L -050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.1.pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 11.10.2013 merr këtë

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtës ndaj Ukë Ibrahim Rugova i lindur me 03.06.1980 në Prishtinë, ku dhe tani jeton në rrugën Hamdi Gashi nr. 24, për kundërvajtje nga 8 par. 1 i ndëshkuar sipas nenit 16 par. 1.3 të Ligjit nr. 04/L -050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar.

Konform neni 198 al.1 pik. 8 të LMK-es Pezullohet Procedura ,pasi që nuk ka provë se ka kryer kundërvajtje. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës

Arsyetim

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr. 01-5029/2011 të dt.27.12.2011, për zhvillimin e procedurës kundërvajtës kundër të lartpërmendurit e për kundërvajtjen e lartcekur, duke propozuar të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit. Gjyqtari në shkallë të parë, me dt. 31.08.2012, ka marrë aktvendim me të cilin Pezullon lëndën në mungesë të provave. Kundër këtij aktvendimi Agjensioni kundër korrupsionit, ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Lartë për kundërvajtje. Gjykata e Lartë me aktvendimin GJL. nr. 1086/2012 dt. 18.10.2012, ka aprovuar ankesën e agjencionit si të bazuar, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e ka abroguar, që të merren edhe këto veprime: të dëgjohet dorëzuesi i postes i cili duhet të dëshmojë se a ja ka derzuar të pandehurit ftesën e AKK-së e cila ka qenë e adresuar në emër të tij apo dikujt tjetër.

Duke vepruar sipas konstatimeve dhe vërejtjeve të theksuara më lartë u dëgjua parashtruesi i kërkesës Enis Sadiku i cili në deklaratën e tij pohoj se e pasi që u njoftova me kërkesën dua të precizoj këto rrethana kohën e kryerjes së kundërvajtjes e cila i vihet në barrë Ukë Rugovës ku shihet se kërkesa për plotësimin e formularit e cila është drejtuar deputetët Ukë Rugova ishte marrë 23.11.2011 ku shihet se për plotësimin e njëjti ka 15 ditë sipas ligjit për ta përmbush dhe pas këtij afati është 08.12.2011 si data e kryerjes së kundërvajtjes e cila është e përcaktuar të pasurisë kemi gjetur gabime me të cilat nuk janë përputhur të dhënat tona në formularët e paraqitur dhe kemi kërkuar në bazë të kërkesës se ky nuk e kishte deklaruar biznesin me emër 08 paragrafi SHPK e që i kemi dhanë afat ligjor 15 ditë që ta plotësojë këtë formular, i cili i ndëshkuar sipas neni 1.5

Në deklaratën e dhanë të dorëzuesit të PTK-së Fejzullah Spahiu i cili deklaroi se, pasi që u njoftova me kërkesën dhe për natyrën e qeshtjes mund të deklaroj se unë në cilësinë e dorëzuesit ku punoj në postin nr. 6 dhe bëj shpërndarjen e të gjitha shkresave nëpër shumë vende po ashtu edhe në Kuvendin e R. Se Kosovës dhe me datën 23.11.2011 e kam derzuar postin dhe për shumë persona tjerë po ashtu edhe për personin Ukë Rugova ku është edhe në librin e dozimit i cili ka qenë në renditje 5 emri i Ukë Rugovës për këtë unë sa i përket mënyrës se dozimit unë e dërgoj në sportelin në hyrjen kryesore të Kuvendit dhe nga unë e pranoni një person, atë ditë me sa më kujtohet a ka pranuar një person me emirin Lumë por nuk jam i sigurt se a është kjo në qofse e siguroj emrin dhe mbiemrin do të njoftoj gjyqtarin se si është emri i vërtet i saj dhe si vepron ajomë shpërndarjen e dërgesave unë nuk e dinë veprimet e çdo herë kështu.

Po ashtu u ftua edhe personi përgjegjës SH.P. Arshivës së Kuvendit të Kosovës, ku kësaj ftese i përgjigjur ftesës Shefqet Hasimi i cili pohoj se pasi që u njoftova me kërkesën unë jam zyrtar ligjor në Ministrinë e drejtësisë ku e bëje përfaqësimin e Ministrisë së Drejtësisë si dhe të Kuvendi, sipas autorizimeve por në rastin konkret nuk kam të bëjë me përfaqësim, por kanë të bëjë me dëshmi të personave konkret, kështu që sa i përket dëshmisë se personi konkret a e ka pranuar apo nuk është pranuar unë nuk mund të deklaroj se nuk i njohe këto rrethana

Gjyqtari pasi që administroi provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetoi gjendjen faktike, duke e dëgjuar të pandehurin, parashtruesin e kërkesës dhe deklarimi i dëshmitarëve si dhe provat e tjera të administruara nga shkresat e lëndës dhe duke vepruar sipas konstatimeve sugjerimet të Kolegjit të shkallës së dytë, dhe prova të tjera të administruar në lëndë, gjyqtari konform neni 198 al.1 pik. 8 të LMK-es e PEZULLOI procedurën kundërvajtjes ndaj të lartpërmendurit. pasi që nuk ka provë se ka kryer kundërvajtje.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes

GJYQTARI
Fatmir Behrami

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund të ushtrojnë palët, Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmjet të këtij Divizioni.

